



KBU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR ERZEN

Nr.18/5 prot
Dt. 08.01.25

VENDIM

Nr.13, date 23/12/2024

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN E LEJES NR.A 1, DATË 5.5.2009, NGA SUBJEKTI “SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME FSHAT ELBASAN” TEK SUBJEKTI “SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN”.

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujqrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Erzen,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin e lejes Nr.A 1, datë 5.5.2009 “Leje për përdorim të rezervës ujqore e lidhje kontrate, për furnizim të popullatës me ujë të pijshëm, nga subjekti “SH.A Ujësjiellës Kanalizime Fshat Elbasan” tek subjekti “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan” sh.p.k me Nipt M23322201V.

2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë:

Emërtimi i burimit	KOORDINATAT KRGJSH		Q
	X	Y	l/s
Burimi Korre	504419.5	4568313.1	4

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU ERZEN

AFRIM QËNDRO

